



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.178/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit XH.A.K. B.I. me numër identifikues 810608200 nga Prizreni, përfaqësuar sipas autorizimit nga Taulant Hodaj avokat, kundër debitorit Al Petrol shpk me numër identifikues 810321662 me seli në Vragoli Komuna e Fushë Kosovës, të cilin me autorizim e përfaqëson Burim Azemi avokat nga SHA Sejdiu&Qerkini shpk, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP nr.2187/22 datës 29.09.2023, me datën 12.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit XH.A.K. B.I. me numër identifikues 810608200 nga Prizreni, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP nr.2187/22 i datës 29.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin KPPP nr.2187/22 dt.29.09.2023, ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Al Petrol shpk,, i paraqitur kundër Urdhrit përmbartimor P.nr.386/22 datës 16.08.2022, i Përmbartuesit Privat Rrezarta Metaj, dhe ka përfunduar në tërsi përmbartimin në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale si dhe me konstatim të gabuar të gjendjes faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë, nuk mund të kuptohet nga aktvendimi i atakuar se si ka arritur gjykata, i propozon ta aprovoj këtë ankesë, të ndryshohet aktvendimi KPPP nr.2187/22 dhe të mbetet në fuqi Urdhri përmbartimor P.nr.386/2022 i datës 16.08.2022.

Në përgjigje në ankesë, debitori deklaroi se ankesa e kreditorit është e pabazuar sepse nuk është e mbështetur në asnjë provë, se aktvendimi i atakuar nuk përbën kurrfarë shkelje të dispozitave të LPP, i propozon gjykatës që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e kreditorit dhe ta vërtetoj aktvendimin e Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP nr.1430/2023 i datës 30.11.2023

Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori XH.A.K. B.I. me numër identifikues 810608200 nga Prizreni, përfaqësuar sipas autorizimit nga Taulant Hodaj avokat në Prishtinë-zyra e avokatëve Hodaj&Partners LLC, me datën 15.08.2022 ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Al Petrol shpk me numër identifikues 810321662 me seli në Vragoli Komuna e Fushë Kosovës, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr.111/2022 dt.19.01.2022. Përmbartuesi Privat Rrezarta Metaj nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.368/22 dt.16.08.2022, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga fatura, ti paguaj shumën prej 13,200.00 euro, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit, debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se kreditori nuk ka asnjë të drejtë të lëshoj fatura ndaj debitorit dhe të kërkoj ndaras pagesën e kontraktuar, propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe ta anuloj në tërësi urdhrin përmbartimor.

Përgjigje ndaj prapësimit të debitorit ka ushtruar i autorizuari i kreditorit duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit. Debitori nuk ka ofruar prova për të vërtetuar pretendimin e tij se nuk ka obligime ndaj kreditorit, i propozon gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ta aprovoi urdhrin përmbartimor.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.2187/22 dt.29.09.2023, me të cilin e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ka anuluar urdhrin përmbartimor, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit dhoma e shkallës së parë vlerëson se fatura në bazë të cilës është lejuar urdhri përmbartimor nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Gjykata vlerëson se fatura nuk është dokument i besueshëm për faktin në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht nuk përmban nënshkrimin e pranuesit-debitorit dhe nuk ka dëshmi se e është pranuar nga debitori.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës nr.111/2022 e

datës 19.01.2022 e lëshuar nga kreditori, në mënyrë të njëanshme, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 të LPP-së.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga dhoma e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Edhe kjo gjykatë vlerëson se fatura me numër nr.111/22, nuk është në pajtim me dispozitat ligjore dhe atë nenin 29 të LPP i cili parasheh që *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, e që në rastin konkret fatura e lartcekur si e tillë nuk plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, sepse e njëjta nuk është e vëlosur nga debitori si dhe as e nënshkruar nga i njëjti, element ky bazë që shpreh vërtetësinë e pranimit të një dokumenti, dhe se e njëjta nuk është pranuar në mënyrë të rregullt ashtu që del të jetë e lëshuar njëanshëm. Po ashtu kjo gjykatë vlerëson se me Udhëzimin Administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, andaj marrë parasysh faktin se fatura nuk është nënshkruar nga debitori dhe se në shkresat e lëndës nuk ka prova se e njëjta është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori rezulton se kjo faturë nuk mund të jetë e përshtatshme për përmbardim.

Dhomat e shkallës së dytë, nuk i aprovoi si të bazuara pretendimet ankimore të kreditorit, dhe jo relevante për një vendosje ndryshe ashtu që i refuzoi si të tilla ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoj. Nuk gjen mbështetje ligjore pretendimi ankimor se dëftesa postare për pranimin e dërgesës dt.20.01.2022 e refuzuar nga debitori, të konsiderohet dokument i besueshëm, si dëshmi se debitori ka pranuar borxhin sipas faturës nr.111/22 dt.19.01.2022.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPP lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.178/24 me datë 12.06.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha